

VENDIM
Nr. 67, datë 3.2.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 743, DATË 16.10.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E PUBLIKUT
NGA RREZATIMET JOJONIZUESE””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10469, datë 13.10.2011, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikat 4.3 dhe 4.9, të rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”, bashkëlidhur vendimit nr. 743, datë 16.10.2012, të Këshillit të Ministrave, afati “... 30 ditë pune ...” zëvendësohet me “... 60 ditë pune ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi